



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

ARJ.nr.56/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Ragip Namani, kryetar, Nebojša Boričić dhe Zenel Leku, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ të paditësit, “M.C”, Sh.P.K., me seli në P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” SHPK, Soliteri Avalla P+12, Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në P., me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.1173/22, të datës 03.07.2023, në seancën e mbajtur me datë, 25 Prill 2024, merr:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi, “M.Co”., Sh.P.K., me seli në P., kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.1173/22, të datës 03.07.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.1173/22, të datës 03.07.2023, REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit, “M. C”., Sh.P.K., me seli në P., e datës 29.12.2021, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.432/20, i datës 13.10.2021, VËRTETOHET.

Paditësi për mes të autorizuarit, Shoqëria e Avokatëve SCRL, “Partners”, sh.p.k., në afat ligjor në Gjykatë Supreme ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, më të cilën e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit të Gjykatës Komerciale për shkak të: aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozim, të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e paditësit, ndërsa të anulohet në tërësi si i pa bazuar aktgjykimi i Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.1173/22, sipas të cilit aktgjykim është refuzuar e pa bazuar ankesa e paditësit e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A nr.

432/20, datë 13.10.2021, me të cilin është refuzuar e pa bazuar kërkesë padia e paditësit dhe është lënë në fuqi aktvendimi i kontestuar i Doganës së Kosovës, 01.3.2.2/9600, 11107, datë 13.09.2019, dhe lënda të kthehet përsëri në rishqyrtim dhe rivendosje pranë gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të kontestuar, sipas pretendimeve në kërkesë të paditësit dhe shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës, gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, me aktvendimin e DK, 01.3.2.2/17909 të datës 16.01.2020, të Doganës së Kosovës, refuzohet kërkesa e subjektit në procedurë, këtu paditësit "M.C"., SHPK – P., për rishqyrtimin e vendimeve (Deklaratave Unike Doganore) nr.R-17577/ 21.11.2019; R-...../.. .../....., dhe R-/..., .../... të ZBD P., ..., si të pabazuar, me arsyetimin se Sektori i Pranimit Qendror dhe Zyra e Inspektimit pas zhdoganimit, ka vepruar drejtë kur e ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, duke caktuar vlerë të re doganore, me metodën e 6-të të vlerësimit nenin 35 i KDA respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme të DK, zhdoganimeve të më hershme dhe dosjes së sektorit të vlerës, vlerësim ky i cili është bërë duke shfrytëzuar informatat e marra nga zhdoganimet e rregullta nëpër degë pasi që vlera e mallit të deklaruar për zhdoganim nuk është çmim real i paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë për arsye se, është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht import në vendin tonë. Për këto arsye DK vlerëson se pas rishqyrtimit të kërkesë me shkrim të palës ankuese paditësit dhe shkresave të bashkangjitura ka konstatuar se malli nuk mund të vlerësohet sipas nenit 33, dhe nenit 34 par.2 pika a) dhe b), por rivlerësimi bëhet në pajtim me nenin 35, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës.

Duke vendosur sipas padisë së paditësit në procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, gjykata e shkallës së parë, merr aktgjykimin e ankimuar, A.nr.432/20, me të cilin Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit "M.C"., Sh.P.K., ndërsa mbetet në fuqi aktvendimi aktvendimin e DK, 01.3.2.2/17909, i datës 16.01.2020, i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Në arsyetim ndër të tjera arsyeton, se nga provat e administruara si në kuptim të nenit 81G të Ligjit 04/L-102 dhe 44 të LKA, gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga organi i paditur, sepse paditësi gjykatës nuk i ka paraqitur prova për të vërtetuar se i ka paguar eksportuesit vlerën reale të mallit lëndor sipas faturave përcjellëse të mallit, për tu bërë zhdoganimi sipas nenit 33 të KDA. Përkundër pretendimeve të paditësit se dokumentet e paraqitura janë të harmonizuara në kuptim të vlerës së deklaruar të mallit lëndor, gjykata konstaton se dokumentacioni i paraqitur në procedurë administrative, i njëjtë edhe në procedurë gjyqësore është i pa mjaftueshëm për tu konstatuar se vërtetë paditësi ka paguar vlerën reale të mallit lëndor. Paditësi pretendimet nuk i mbështet në fakte si në vështrim të nenit 81. F të Ligjit 04/L-102 ,andaj Gjykata nuk ka mundur të provoj se është bërë pagesa sipas faturave përcjellëse të mallit lëndor të lëshuara nga eksportuesi E., ...-B., AL B,T., EST-Emiratet e Bashkuara Arabe, sepse për tu pranuar vlera e deklaruar dhe e paguar sipas metodës së parë sipas nenit 33 të

KDA është dashtë të dëshmoj para të paditurës dhe gjykatës vlerën e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit ekspertuesit. Andaj me që nuk arrin të dëshmoj këtë fakt për mes dokumentacionit përcjellës gjykata i pranon konstatimet e cekura në arsyetim të vendimit kontestues të paditurës se dokumentacioni përcjellës i mallit është provë e pa pranueshme, pasi që fakt vendimtar për tu dëshmuar se e ka paguar vlerën e deklaruar e që në këtë rast është, transaksioni bankar apo çfarë do pagese tjetër për mallin e importuar, për deri sa paditësi nuk ka qenë në gjendje që të dëshmoj me asnjë provë materiale as në procedurë administrative dhe as në konflikt administrativ.

Meqenëse nga provat e prezantuara nga paditësi në procedurë gjyqësore nuk është provuar vlera reale e mallit lëndor ashtu si pretendon, se dokumentacioni përcjellës të cilin e ofron është në përputhje me nenin 123 të U.A. 11/ 2009, gjykata nuk ka mundur të vërtetoj gjendje tjetër faktike nga gjendja e konstatuar nga e paditura, andaj vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë kur me vendimin kontestues e ka konfirmuar rivlerësimin e mallit lëndor nga Zyra e Pranimit Qendror, duke aplikuar metodën e 6 të vlerësimit, sipas nenit 35, të Kodit Doganor dhe të Akcizave, përkatësisht sipas të dhënave të disponueshme – zhdoganimeve të mëhershme dhe dosja e vlerës. Andaj në kuptim të dispozitave ligjore nga neni 81.1 par. 2 pika 2.1, të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, K.DH.SH.II.nr.1173/22, e refuzon si të pabazuar ankesën e paditësit, duke e pranuar si të drejtë dhe ligjor qëndrimin juridik të shkallës së parë si në aktgjykimin e saj me refuzimin e kërkesë padisë së paditësit, sepse në procedurë të vlerësimit të ligjshmërisë së tij si në kuptim të nenit 81.H të Ligjit 04/L102 dhe nenit 49 të LKA, nuk gjen prova se i njëjti është i përfshirë me shkelje sipas pretendimeve në ankesë dhe as me shkelje qenësore të dispozitave të LKA dhe të LPK, të cilat i ekzaminohen si në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Kolegji i gjykatës së shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë nga provat e mjaftueshme të administruara drejtë ka konstatuar gjendjen faktike kur gjen se, kërkesë padia e paditësit është e pa bazuar sepse paditësi nuk ka dëshmuar me dokumente adekuate dhe bindëse për të dëshmuar vlerën reale të paguar për mallin lëndor sipas DUD-ve kontestues dhe për tu bërë zhdoganimi sipas nenit 33 të KDA, andaj vlerëson se gjykata e njëjtë me të drejtë i ka pranuar të gjeturat si në vendimin e organit të paditur me që paditësi edhe në procedurë ankimore nuk ofron prova që do të argumentonin pretendimet e tij dhe për tu vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimet ankimore lidhur me aplikimin e gabuar të drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë po ashtu u refuzon si jo të bazuara për faktin se nga gjendja faktike e vërtetuar në mënyrë të plotë sipas çështjes në shqyrtim dhe arsyetimit të dhënë mbi faktet vendimtare rezulton se edhe e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme pas ekzaminimit të aktgjykimin të kontestuar dhe shqyrtimit të pretendimeve nga kërkesa, gjen se gjykata e shkallës së dytë ka vepruar drejtë me refuzimin si të pabazuar të ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktgjykimin të shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës Komerciale në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, meqë aktgjykimi i kontestuar nuk është i përfshirë me aplikim të gabuar të dispozitave ligjore materiale dhe procedurale në të cilat paditësi thirret në kërkesën e tij.

Sipas nenit 33, paragraf,1 të Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë (KDAK) përcaktohet se: *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë”*,

Sipas nenit 34 paragraf 1 të këtij kodi përcaktohet se: *“Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë), që lejon përcaktimin e asaj vlere, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e aplikimit të nën-paragrafëve (c) dhe (d) mund të kapërcehet me kërkesën e deklaruesit; Vetëm në rast kur vlera nuk mund të përcaktohet në bazë të një nën-paragrafi të caktuar, lejohet të aplikohen dispozitat e nën-paragrafit që vjen me radhë menjëherë pas tij”*.

Sipas nenit 35 paragraf 1, të këtij kodi përcaktohet se: *“Kur vlera doganore e mallrave të importuara nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 33 ose 34, do të përcaktohet në bazën e të dhënave të disponueshme në Kosovë, duke përdorë metoda të arsyeshme në përputhje me parimet dhe dispozitat e përgjithshme: - Marrëveshjen për implementimin e Nenit 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë e vitit 1994;. - Nenit 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë e vitit 1994; - Dispozitave të këtij kreu”*.

Sipas nenit 123 paragraf 41 pika (a) të Udhëzimit Administrativ Nr.11/2009, për Implementimin e Kodit të Doganave dhe Akcizës, Seksioni 4 (Dokumentet që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore) përcaktohet se: *“Dokumentet në vijim duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë: a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*

Ndërsa sipas nenit 91 të këtij udhëzimi përcaktohet se: *“Personi i referuar në Nenin 88 (2) të këtij akti, duhet të paraqes doganës kopjen e faturës mbi bazë të së cilës e paraqet vlerën e mallit të importuar. Kur vlera doganore është deklaruar me shkrim, Dogana do të mbajë atë kopje”*.

Bazuar në dispozitat e cituara si më lartë, kjo gjykatë vlerëson se gjykatat e instancave më të ulëta sipas gjendjes së vërtetuar të çështjes në shqyrtim, kanë vendosur në mënyrë të drejtë në baza ligjore me refuzimin e kërkesëpadisë, përkatësisht ankesës së paditësit për faktin se edhe në procedurë gjyqësore është vërtetuar që paditësi nuk ka ofruar prova të nevojshme për tu dëshmuar se të paditurës i ka paraqitur të gjitha dokumentet e nevojshme për tu pranuar vlera doganore e mallit të importuar sipas vlerës së deklaruar, ashtu siç përcaktohet me nenin 33 paragraf 1 të KDAK-së, në mungesë të transfereve bankare, apo çfarëdo pagese tjetër për mallin e importuar, të harmonizuara me vlerën e faturave, të paguara shitëseve, “E., ...-B., AL B., EST-Emiratet e Bashkuara Arabe, ashtu si parashihet si në kuptim të nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009. Nga kjo gjendje e vërtetuar gjykatat e instancave më të ulëta me të drejtë nuk kanë mundur ti pranojnë pretendimet e paditësit se vlera e deklaruar e mallit paraqet vlerën e tij reale, si e thekson edhe tani në kërkesë, në mungesë të dëshmive të nevojshme për tu provuar vlera e transaksionit të paguar për mallin lëndor.

Andaj konstatimet e organit të paditur si të drejta dhe të ligjshme i pranon edhe kjo gjykatë, me që nga paditësi nuk dëshmohet se ka prezantuar dokumentacionin e kompletuar nga i cili do të vërtetohet se çmimi i deklaruar paraqet vlerën reale të mallit lëndor, andaj si rrjedhojë e kësaj edhe organi i shkallës së dytë ka vepruar drejtë kur me vendimin e kontestuar ka konfirmuar rivlerësimin e mallit nga Sektori i Pranimit Qendror, duke aplikuar metodën e 6 (gjashtë) të vlerësimit nga neni 35, i Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109, përkatësisht rivlerësimin e bërë në bazë të dhënave me të cilat disponon Dogana dhe dosja së vlerës, në mungesë të provave-dokumentacionit përcjellës të harmonizuar të mallit të paraqitur nga paditësi.

Pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës i cili ndër të tjera thekson, se në një rast tjetër vet e paditura ia ka pranuar vlerën e deklaruar dhe paditësit i janë kthyer mjetet më tepër të paguara, ndërsa në këtë rast në mënyrë arbitrare pa bazë ligjore nga e paditura i është rritur baza doganore, ndërsa pretendimet e tij janë refuzuar nga gjykatat më të ulëta, Gjykata Supreme i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson nuk janë të qëndrueshme në fakte dhe prova valide. Si të tilla janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta, dhe me të drejtë janë refuzuar si të pabazuara dhe të pa argumentuara, prandaj nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe në këtë çështje nga ajo e vendosur gjykatat e instancave më të ulëta, gjer sa paditësi në asnjë fazë nuk ka paraqitur dëshmi shtesë në procedurën ankimore në organin administrativ dhe as para gjykatave të instancave më të ulëta për ti argumentua pretendimet e tij. për derisa sipas nenit 7 paragraf 1 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore përcaktohet se; *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Nga gjendja si më lartë rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë bërë aplikimin e dispozitave të LKA, LPK, dhe dispozitave materiale të Kodit Doganor dhe të Akcizave. Aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të qartë të kuptueshëm dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, dhe në këtë çështje nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit.

Nga theksimet si më lartë dhe në pajtim me nenin 54 paragrafi 1, të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ.nr.56/2024, me datë 25 Prill 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani